



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE MJEDISORE DHE JETËSIMI I
PRIORITEVE
DREJTORIA E MJEDISIT
Sektori i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, Vlerësimit Strategjik Mjedisor, Ndotje
Industriale dhe Standarteve Mjedisore

Nr. 4158/12 Prot.

Tiranë, më 28.06.2017

Drejtuar: Z. Shkëlqim BOZGO
"TRANS ADRIATIC PIPELINE AG ALBANIA"
Adresa : Rruga "Papa Gjon Pali II", ABA Business Center ,Tiranë

Lënda: Dërgim Vendimi për VNM paraprak

Bazuar në Kreu 1, pika 11 të Vendimit të Këshillit të Ministrave me Nr. 686, datë 29.07.2015 "Për miratimin e rregullave të përgjegjësisë e të afateve për zhvillimin e procedurës së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore", gjeni bashkëlidhur Vendimin për VNM paraprake me Nr. Prot. 1531 datë 27.06.2017, Nr. Identifikimi 445, Vendimi 26 të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit.

Pëllumb ABESHI
DREJTORI I PËRGJITHSHËM



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT MJEDISOR

Nr. 1531 Prot.

Tiranë, më: 27 . 06 . 2017

Nr. Identifikimi 445

Vendimi 26

VENDIM

PËR VNM PARAPRAK

Në mbështetje të Ligjit Nr. 12/2015 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440”, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, VKM Nr. 686, datë 29.7.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore”,

AKM-ja pas përfundimit të procedurës paraprake të VNM-së, vendosi që ky projekt nuk duhet t’i nënshtrohet procedurës së VNM së thelluar për zhvilluesin me të dhënat si më poshtë:

Person juridik: “TRANS ADRIATIC PIPELINE AG ALBANIA”

Nr. NIPT-i: K924020230

Adresa e selisë: Rr. “Papa Gjon Pali II”, ABA Busines Center, Tiranë

Personi përgjegjës: Shkëlqim Bozgo

Për të zhvilluar projektin “Devijimi i gazësjellësit T.A.P. Albania në zonën e Orizaj”

Aplikimi është bërë referuar Ligjit Nr. 10 440, datë 7.7.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, Shtojca II, pika 10/d) Ndërtim rrugësh, portesh dhe instalimesh për porte, duke përfshirë dhe portet e peshkimit (projekte që nuk përfshihen në shtojcën I);

Vendndodhja: Orizaj, Skrapar, Qarku Berat

Gjatësia e gjurmës: 0.850 km

(Bashkangjitur Aneksi 1, gjendet gjurma e projektit.)

Bazuar në nenin 11 të Ligjit Nr. 10440, datë 7.7.2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis" ndryshuar , më poshtë po listojmë:



1. Arsyet dhe konsideratat kryesore, ku është mbështetur mendimi

Zhvillimi i aktivitetit nuk prek:

- Zona të mbrojtura

2. Mendimi i institucioneve të konsultuara:

Drejtoritë Teknike të Ministrisë shprehin mendimin si më poshtë vijon:

- Rekomandojme mbajtjen parasysh të referencave ndaj ligjit të pyjeve dhe të dhënave kadastrale për pyjet dhe kullotat.
- Mjetet teknologjike që do të transportojnë apo transferojnë mbetjet të jenë të pajisur me licencë të tipit III.2.B, si detyrim i ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" të ndryshuar;
- Mbetjet që do të krijohen të specifikohen sipas kodit të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 99, datë 18.2.2005, "Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve" të ndryshuar;
- Gomat jashtë përdorimit të cilat krijohen gjatë aktivitetit të dorëzohen dhe t'i përmbahen kërkesave të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 652, datë 14.09.2016 "Për rregullat dhe kriteret e menaxhimit të mbetjeve nga gomat e përdorura"
- Mbetjet e rrezikshme nëse do të gjenerohen, t'i dorëzojë sipas kërkesave të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 371, datë 11.06.2014 "Për përcaktimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe miratimin e dokumentit të dorëzimit të mbetjeve të rrezikshme;
- Vajrat e makinerive që klasifikohen si mbetje jashtë përdorimit të dorëzohen sipas kërkesave të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 765, datë 07.11. 2012 "Për rregullat dhe procedurat për asgjësimin e vajrave të përdorur";
- Transferimi i mbetjeve jo të rrezikshme të shoqërohet me plotësimin e Shtojcës 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 229, datë 23. 04. 2014 "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme;
- Mbetjet inerte që do të gjenerohen ti përmbahen kërkesave të pikave 7, 12 dhe 20 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 575, datë 24.06.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte"
- Bateritë e automjeteve që klasifikohen si mbetje jashtë përdorimit dhe të rrezikshme të dorëzohen sipas kërkesave të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 866, datë 4.12.2012 "Për bateritë, akumulatorët dhe mbetjet e tyre"

Drejtoria rajonale e Mjedisit Berat shprehet: pozitiv për zhvillimin e projektit.

3. Përshkrimin, sipas rastit, të masave kryesore që duhen marrë për të shmangur, reduktuar nëse është e mundur, për të korrigjuar efektet negative të rëndësishme:



- 1 Ky vendim është i vlefshëm, nëse ndërtimi i objektit është në përputhje të plotë me Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Planin e Detajuar Vendor, të miratuar nga organet kompetente (KKT / Bashkia /Njësi Administrative) dhe akteve ligjore në fuqi.
- 3.2 Subjekti duhet të marrë miratim për gjurmën e re, nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë, si palë e kontratës konçensionare.
- 3.3 Në rast se gjatë punimeve shfaqen elemente të tilla si: objekte kulti, gjurmë arkeologjike, burime ujore etj, subjekti të ndërpresë punimet dhe të lajmërojë urgjentisht organet kompetente.
- 3.4 Të kryhen punime vetëm në gjurmët e projektit të propozuar.
- 3.5 Masa e dheut e gjeneruar nga operacionet e gërmimit, të sistemohet në një vend të caktuar dhe të ruhet për qëllimin e rehabilitimit.
- 3.6 Të merren masa për të parandaluar rëniet e zjarrit gjatë realizimit të punimeve në terren dhe të sigurohen mjetet e nevojshme të ndërhyrjes në rast të rënies së zjarrit (zjarrfikse të lëvizshme, bombula me shkumë, etj);
- 3.7 Në rast se do të ketë prerje pemësh, të zëvendësohen në raportin “pri një-mbill tre”, në bashkëpunim me DShP e rrethit.
- 3.8 Në rast se gjate germimeve do te ndeshen objekte kulti e monumente kulture me rëndësi kombëtare, historike e arkeologjike, te lajmerohen organet kompetente, per vazhdueshmerine e punimeve.
- 3.9 Niveli i zhurmave gjatë procesit të jetë brenda normave të lejuara dhe të punohet në orare kur shqetësimi i banoreve dhe zonave përreth të jetë me ndikim sa më të ulët.
- 3.10 Të bëhet kujdes rreth zonës ku do të realizohen punimet, për të shmangur hyrjet e pautorizuara.
- 3.11 Gjatë fazës së ndërtimit të mbahet nën kontroll ndotja e ajrit, brenda standarteve të OBSH-së;
- 3.12 Subjekti të kujdeset për menaxhimi e mbetjeve të krijuara nga veprimtaria, ato të ambalazhimit dhe ndërtimit, duke i transportuar në mënyrë të rregullt në vend grumbullimet e caktura nga njësia vendore. Zotëruesit e mbetjeve inerte duhet të zbatojnë detyrimet që janë të përcaktuara në VKM nr.575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”.
- 3.13 Për asnjë arsye mos të ketë hedhje të mbetjeve inerte pranë burimeve ujore.
- 3.14 Vendosja e ndriçimit gjatë rrugës të bëhet në bashkëpunim me organet kompetente të energjisë elektrike.
- 3.15 Subjekti të realizojë në mënyrë të menjëhershme çdo ndërhyrje teknike për të riparuar çdo fenomen negativ në mjedis si pasojë e veprimtarisë së tij, si rrjedhje të pakontrolluara, njolla të ndryshme...etj, me ndikim negativ në mjedis, gjatë fazës së zbatimit të projektit.
- 3.16 Kompania të ndjek me përpikmëri projektin teknik për të evituar erozionin e tokës, me qëllim ruajtjen e cilësisë së ujrave sipërfaqësore dhe nëntokësore.
- 3.17 Të vendoset sinjalistika paralajmëruese përgjatë gjithë segmentit të punimeve me qëllim shmangien e aksidenteve njerëzore.
- 3.18 Në raste aksidentesh ose defektesh që shkaktojnë ndotje të mjedisit, subjekti menjëherë duhet të jap informacion në DRM-në e qarkut përkatës dhe AKM, të cilat bëjnë të mundur njoftimin e popullatës që preket nga ky aksident.

- 3.19 Para fillimit të veprimtarisë të trajnohen të gjithë punëtorët e subjektit si dhe të njihen me termat dhe kushtet e sipercituara ne Vendim.
- 3.20 Kompania duhet të respektojë gjithashtu edhe kushtet e vendosura në raportin e VNM-së që është paraqitur në aplikim si dhe të ketë parasysh Ligjin Nr. 10 431, datë 9.6.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit"
- 3.21 Në përfundim të punimeve, të sillat pranë AKM një raport mbi gjendjen e mjedisit të shoqëruar me foto dhe mbi punimet rehabilituese gjatë gjithë vijës së projektit.

4. Baza ligjore në fuqi.

- 4.1 Ligji Nr. 12/2015 Për Disa Ndryshime Në Ligjin Nr. 10 440, Datë 7.7.2011, "Për Vlerësimin e Ndikimit Në Mjedis"
- 4.2 Ligji Nr. 10 431, datë 9.6.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit".
- 4.3 VKM Nr.686, datë: 29.07.2015 "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe procedurës së transferimit të vendimit dhe deklaratës mjedisore",
- 4.4 VKM-se Nr. 575, datë 24.06.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte.

Në bazë të udhëzimit të MM dhe MF nr. 7938, datë 17.7.2014 "Për përcaktimin e tarifave dhe vlerave përkatëse për shërbimet që kryen Ministria e Mjedisit për procesin e VNM-së", ky subjekt ka kryer pagesen 30.000 lekë.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM I AKM

JULIAN BEQIRI



Aneksi 1. Planvendosja e projektit

PK (2D)	Koordinatat	
	X	Y
110.62	4429509.79	4488667.16
111.76	4428697.62	4488488.59



